# DËSHMI ARKIVI

**A-456231**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | U ekzekutua me plumb në kokë në Itali, publikohet fotoja e 35-vjeçarit shqiptar |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1392559.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 18 shtator 2026, 18:46:10 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 18 shtator 2026, 18:30:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 18 shtator 2026, 18:29:00 UTC → 18 shtator 2026, 18:31:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `af66c0fb88830436b27610f8d7fd61846fcc6814f649b4d360b5b35204437db5` |
| TEKSTI | `43c2851c39ce93cc50089593644eccab9e5c29c0a031eb0839fb1e3a2fadb3db` |
| PAMJA | `6c7ca728fc5ecfe2bc022567f98ebf30215ab7309673febd86f571b9189458f0` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `b5754ffe88dd923cfc75b00a876f1cda095bde5f87b6a904b493b7235d302492` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `214493168e8eaddb39b9693f5adfa0b73b0dd908a9438af0217b4721b8b2f352` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/b5754ffe88dd923cfc75b00a876f1cda095bde5f87b6a904b493b7235d302492`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# U ekzekutua me plumb në kokë në Itali, publikohet fotoja e 35-vjeçarit shqiptar

Shkruar nga: M Gjini | Publikuar më: 18.09.2026, 20:30

Share Share



Është publikuar fotoja e 35-vjeçarit nga Kurbini, Ferdinant Hoti, i cili u gjet i vrarë brenda një automjeti të hedhur në lumin Tergola në Itali. Trupi i pajetë i të riut është sjellë tashmë në Shqipëri, ndërsa ceremonia mortore do të zhvillohet këtë të diell në fshatin Gurrëz të Kurbinit, ku familjarët dhe të afërmit do t'i japin lamtumirën e fundit.

Sipas medieve italiane, Hoti është ekzekutuar me një plumb të vetëm në kokë. Hetuesit besojnë se krimi i rëndë ka ndodhur në provincën e Venecias ku ai jetonte, dhe jo në San Giorgio delle Pertiche, vendi ku u zbulua automjeti. Autorët dyshohet se e kanë transportuar trupin pas ekzekutimit për të zhdukur gjurmët.

Mënyra e fshehjes së trupit ngre dyshime se në skemë janë përfshirë disa persona, të cilët mund të kenë bërë kontrolle paraprake në zonë. Vendi ku u braktis makina ndodhet në rrugë dytësore dhe është i vështirë për t'u gjetur nga persona që nuk e njohin mirë territorin.

Grupi hetimor po vijon punën për zbardhjen e motiveve të vrasjes. Përveç pistës së prishjes së pazareve të drogës, po verifikohet edhe një hakmarrje e mundshme e lidhur me një atentat të ndodhur në natën mes 30 qershorit dhe 1 korrikut në Zianigo di Mirano. Në atë ngjarje, një tjetër shqiptar u plagos me armë zjarri në shpatull pranë banesës së tij. Po shqyrtohet nëse Hoti kishte lidhje me rrethin e personave të përfshirë, megjithëse deri më tani autoritetet italiane nuk kanë gjetur prova konkrete që bashkojnë të dyja ngjarjet.

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

## TË NGJASHME



Më të Lexuarat

ARTIKULL JOETIK?

## Më të fundit




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.